IV

# KUVENDI I KOSOVËS
# СКУПШТИНА КОСОВА
# ASSEMBLY OF KOSOVO

**MEMORENDUM ZYRTAR** **СЛУЖБЕНИ МЕМОРЕНДУМ**

| | | | |
|---|---|---|---|
| **PER / ЗА / TO** | Të gjithë Deputetët e Kuvendit<br>Све посланике у Скупштине<br>All Members of the Assembly | **DATA<br>ДАТУМ<br>DATE** | 11 prill 2002<br>11. Април, 2002.година<br>11 April 2002 |
| **NGA / ОД / FROM** | Franck Boulin / Френк Булин<br>Ushtrues i detyrës së Sekretarit të Kuvendit<br>Вршилац Дужности Секретара Скупштине<br>Acting Secretary to the Assembly | | |
| **SUBJEKTI<br>ПРЕДМЕТ<br>SUBJECT** | Mbledhja e Kuvendit / Заседање Скупштине / Meeting of the Assembly | | |

Mbledhja e ardhshme e Kuvendit do të mbahet të:

**Martën më 16 prill 2002 në orën 11**
**në ndërtesën e Kuvendit të Kosovës, Prishtinë.**

Ftohet të gjithë Deputetët e Kuvendit të marrin pjesë.

Rendi i ditës është i bashkëngjitur.

Следеће заседање Скупштине одржаће се:

**у уторак 16. априла у 11.00 часова**
**у скупштинској сали у Згради владе, у Приштини.**

Сви посланици се позивају да присуствују.

Дневни ред је у прилогу.

The next meeting of the Assembly will take place on:

**Tuesday 16 April at 11am**
**in the Assembly Hall of the Government Building, Pristina.**

All members of the Assembly are invited to attend.

The agenda for the meeting is attached.

# KUVENDI I KOSOVËS
# СКУПШТИНА КОСОВА
# ASSEMBLY OF KOSOVO

**Mbledhja e Kuvendit / Заседање Скупштине / Meeting of the Assembly**

E martë, 16 prill 2002 prej orës 11:00 / Ndërtesa e Kuvendit, Prishtinë
Уторак 16. април у 11.00 часова / Скупштинска сала, Зграда владе, Приштина
Tuesday, 16 April 2002 from 11:00 hrs / Assembly Building, Pristina

## RENDI I DITËS

1. Fjala e Kryetarit të Kuvendit
   - Konfirmimi i propozimit për Ministër pët Bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural
2. Mocioni për ndryshimin e Kornizës Kushtetuese për të lejuar një anëtarë shtesë në Kryesinë e Kuvendit

   Propozohet: Në përputhje me nenin 14.3 të Kornizës Kushtetuese, Kuvendi i Kosovës kërkon të bëhet ndryshimi i mëposhtëm në nenin 9.1.7 për Kryesinë e Kuvendit:

   Të shtohet një nënparagraf i ri:

   "(d) Një anëtarë emërohet nga partia ose koalicioni që ka marrë numrin e katërt më të madh të votave në zgjedhjet për Kuvned"

   Rinumërimi i nënparagrafëve (d) dhe (e) ekzistues me (e) dhe (f). *(Vërejtja e përkthyesit: në shqip (ç) dhe (d) me (d) dhe (e))*

   [Kryesia]

3. Miratimi i numrit dhe emërtimeve të Komisioneve
4. Miratimi i Kryesuesve dhe Zëvendës-kryesuesve të Komisioneve

## ДНЕВНИ РЕД

1. Излагање Председника Скупштине
   - Потврђивање кандидата за Министра Пољопривреде, Шумарства и развоја села
2. Предлог за измену и допуну Уставног оквира како би се омогућило довођење новог члана у Председништво Скупштине

   Предлог: У складу са чланом 14.3 Уставног оквира, Скупштина Косова захтева да следећа измена и допуна утиче на члан 9.1.7 о Председништву Скупштине;

   Додавање новог става:

   Ч(d) једног члана именује странка или коалиција која је добила четврти највиши број гласова на скупштинским изборима;Ч.

   Промена редних бројева осталих ставова (d) и (e) у (e) и (f).

   [Председништво]

3. Усвајање броја и имена Одбора

# AGENDA

1. Statement by President of the Assembly
   - Confirmation of the nominee for Minister of Agriculture, Forestry and Rural Development

2. Motion to amend the Constitutional Framework to allow for an additional member on the Presidency of the Assembly

   Proposed: Pursuant to section 14.3 of the Constitutional Framework, the Assembly of Kosovo requests that the following amendment be effected in section 9.1.7 on the Presidency of the Assembly;

   Add a new subparagraph:

   "(d) one member shall be appointed by the party or coalition having obtained the fourth highest number of votes in the Assembly elections;".

   Renumber the existing subparagraphs (d) and (e) as (e) and (f).

   [The Presidency]

3. Endorsement of the number and titles of Committees

4. Endorsement of Chairperson and vice Chairpersons of Committees

IV

MBAJTUR ME 16.4.2002

KUVENDI I KOSOVËS

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Hapi mbledhjen plenare të Kuvendit të Kosovës, me rendin e ditës që paraprakisht e keni marrë të gjithë. Siç mund të keni vërejtur, në rend dite është:

Konfirmimi i propozimit për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltari dhe zhvillim rural.

Pyes përfaqësuesin e grupit Parlamentar të Koalicionit a janë të gatshëm që të bëjnë nominimin e kandidatit për këtë post, urdhëroni

SABRI HAMITI LDK

Flas në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës në Kuvend.
Duke parë që në veri të Mitrovicës dhe në Mitrovicë është shkelur Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, duke parë që në Mitrovicë të veriut nëpërmjet dhunës janë krijuar struktura pushtetore paralele, të cilat nuk njohin strukturat pushtetore tjera as ligje të Kosovës, duke parë që grupe paramilitare të sigurisë serbe të dirigjuara nga Beogradi ushtrojnë dhunë permanente e cila që hove hove e merr karakterin e konfliktit dhe për pasojë ka sjellë vrasjen , plagosjen e dhjetëra civilëve shqiptarë si dhe shpërnguljen e mijëra të tjerëve në tri vitet e fundit, duke parë që këto grupe të emëruara si rojet e urës apo ndryshe, kanë ushtruar terror edhe mbi forcat e sigurisë të Kosovës që t'i largojnë nga ky vend, duke përdorur shumë lloje të armëve, duke parë që marrëveshja e nënshkruar para dy viteve në mes të autoriteteve lokale KFORIT, UNMIK-ut dhe të partive më të mëdha politike të Kosovës nuk është zbatuar fare, jemi të vetëdijshëm se janë krijuar tensione të larta gati shpërthyese në Kosovë, janë krijuar enklava serbe si bërthama të prishjes të stabilitetit dhe pengimit të demokracisë në Kosovë, prandaj në mënyrë që situata mos të rrëshqas deri në nivelin e konfliktit përgjegjësitë e veta duhet t'i

marrin forcat ndërkombëtare, si dhe përfaqësuesit legjitimë të shqiptarëve ,që kanë obligim t'i udhëheqin zhvillimet në Kosovë në dobi të qytetarëve.

Kërkojmë nga KFOR-i që të sigurojë integritetin territorial të Kosovës, pra të ruajë kufijtë e saj, kërkojmë nga UNMIK-u të ruajë sigurinë e brendshme, meqë e ka mandatin e sigurimit të Kosovës ,kërkojmë nga Kryetari i Kosovës dhe nga Qeveria e Kosovës të ndërmarrin masat e veprimet e nevojshme për shpëtimin e kësajë pjese të Kosovës, kërkojmë nga Kryeadministratori Mihajl Shtajner që nëse emëron koordinator serbë për kthimin e të shpërngulurve le ta emërojë edhe një koordinator shqiptar për këtë qëllim në zyren e tij,kërkojmë që të anulohet marrëveshja e nënshkruar nga ish administratori i Kosovës Hans Hakerup dhe përfaqësuesi serb Çoviq. Jemi të bindur që situata mund të zgjidhet në dobi të gjithë qytetarëve të Kosovës nëse masat e kërkuara zbatohen në një afat të përcaktuar, nëse jo Kuvendi i Kosovës si organi më i lartë përfqaqësues duhet të marrë përgjegjësi për sigurimin e lirisë të qytetarëve të Kosovës, dhe sigurimin e integritetit të territorit të saj.

Unë kërkoj që në bazë të regullës 5 të Rregullores të përkohëshme për punën e Kuvendit në faqen 6 bazë, të regullës 7 ,në faqen 9 dhe në bazë të rregullës 17, dhe të hyjë kjo problematikë si temë e diskutimit në Kuvend. Në të njejtën kohë nëse kjo nuk ndodh deri kjo, ju lus grupet tjera parlamentare të mbështetin këtë kërkesë dhe këtë preokupim të madh të deputetëve të Lidhjes Demokratike të Kosovës.Ju falemnderit

**KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI**

Unë mendova që LDK-ja do të propozojë diçka për rendin e dites.

Ju lutem për informim,në mbledhjen e fundit të Kryesisë së Parlamentit njëzëri jemi marrë vesh që kjo çështje, për shkak të seriozitetit e të kompleksitetit, të shqyrtohet në një mbledhje të veçantë në Kryesi dhe të respektohen regullat, të gjitha normat që në rend dites të seancës së Parlamentit të vijnë çështjet e përgatitura . Prandaj, unë nuk e besoj që sot do të ishte mirë të hapim debat, unë kam pasur një plan që një informat ta japë, kjo

temë është hapur në takimin e e fundit që kan patur 5 personalitetet që zënë vendet e ndryshme, Kryetari i Kosovës, Kryeministri, Parlamenti, Z. Shtajner dhe Gjenerali Valenten. Të papërgaditur nuk e besoj që është mirë që vetëm të debatojmë, prandaj nuk jam i mendimit që sot duhet ta hapim këtë çështje, sot është kah bisedohet në të gjitha nivelet prandaj, ta pregadisim mirë e mandej të fillojmë me rendin e ditës. Urdhëro z. Saviq në qoftëse keni nominim për Ministër të Bujqësisë e jo për këtë.

**GOJKO SAVIQ KP**

Poštovani predsedniče, kolege poslanici, ja mislim da je Predsednik Skupštine bio jasan, kada je rekao da počinjemo sa prvom tačkom dnevnog reda i pročitao šta u stvari sadrži prva tačka dnevnog reda, a to je potvrđivanje kandidata Ministarstava poljoprivrede i šumarstva...Uljudno bi bilo da je kolegi poslaniku koji je iskoristio Skupštinsku govornicu za jednu kratku promociju bio isključen mikrofon odmah, kao što je do sada to činilo, jer je na dnevnom redu jasno rečeno šta teče sam rad Skuštine i kako teče rad Skupštine, ovo što je rečeno to je moglo biti rečeno prilikom usvajanja dnevnog reda to nije dato na glasanje prema tome,mislim da ne treba u buduće ovako raditi dozvoliti da kaže a onda nečemo to danas kad prikupimo podatke i ostalo. Ja vas molim da u budučе strogo vodimo računa da primenjujemo potpune iste aršine kada je u pitanju znači izlazak van teme, i kada isključimo mikrofon, hvala

**FATMIR LIMAJ PDK**

Të nderuar z. Kryetar të nderuar deputet edhe unë në emër të grupit Parlamentar të Partisë Demokratike e mbështes propozimin për të futur në rend dite çështjen dhe problematikën në veri të Kosovës të propozuar nga përfaqësuesit e Llidhjes Demokratike të Kosovës. Kam edhe një shtesë, përveç asaj këtu duhet të trajtohet edhe çështja e kufirit të Kosovës, marrëveshja Serbi-Maqedoni janë dy tema që duhet të trajtohen domosdo në Kuvendin e Kosovës. Ne respektojmë dhe çmojmë angazhimet që bëjnë personalitetet tona në nivele të ndryshme, mirëpo nuk ka asnjë organ më serioz dhe ma autoratitiv, dhe që ka për obligim me u marrë me këto çështje se sa Parlamenti i Kosovës.Kisha kërkuar

nga Kryetari dhe Kryesia që herave të tjera çështjet që janë jetike dhe ngjarjet që zhvillohen në Kosovë të mos ketë nevojë ti shqyrtoi tjetërkush, por ne të dalim me qëndrimet tona. Prandaj dhe propozojmë në rend dite dhe ne vetë duhet të merremi me diskutimin e këtyre çështjeve. Prandaj kërkoj që çështja aktuale në veri të Kosovës dhe marrëveshjet për kufi mes Serbis dhe Malit të Zi të trajtohen në Kuvendin e Kosovës.

**BUJAR DUGOLLI AAK**

I nderuari kryetar, të nderuar deputetë, në rend të parë shprehi një paknaqësi timen të grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës për zhagitjen e punës të Kuvendit që po bëhet. Unë mund të them se nga konstutuimi i këtij organi dhe pas ratifikimit t ë n jë m arrëveshje p olitike m es f orcave p olitike q ë ë shtë b ërë j ashtë k ëtij Kuvendi, Kuvendi nuk ka debatuar asnjëherë dhe nuk ka bërë asnjë punë në dobi të çështjes sonë dhe për të diskutuar problemet me të cilat ballafaqohet shoqëria jonë.

Mendoj që përveç rendit ditës që është paraqitur dhe me të cilin ne pajtohemi, por gjithsesi sipas propozimeve edhe të dy shefave të g rupeve parlamentare të dy partive tjera që të lejohet një debat, ku do të diskutonim për çështjet që janë shumë domethënëse dhe shumë preokupuese për shoqërinë tonë.

Dhe në fund të propozohet një projektrezolutë që të nxiret nga Kuvendi për këto çështje që janë shumë të rëndësishme. Aspekti i sigurisë, sulmet e ekstremistëve serbë në pjesën veriore si ndaj policisë ndërkombëtare, ashtu edhe ndaj veprimtarëve politikë, ku rasti i djehit ishte sulmi mbi një veprimtar politik të AAK-së në shtëpinë e tij, mendoj edhe çështja e kufirit ështe çështje shumë shqetësuese, e cila po reflektohet edhe te popullata.Ishin demonstrimet paqësore shqiptare edhe dje ato që flasin se organi më i lartë i Kosovës Parlamenti i Kosovës duhet të diskutoj këto, përndryshe qytetarët mund të ndërmarrin edhe veprime tjera që më vonë do të ishte vonë për t'i diskutuar, dhe mendoj që ti hapet rruga edhe kësaj pike të rendit të ditës që u propozua të diskutohet dhe të nxirret një projektrezolutë që me shumë çështje pajtohemi që u tha parafolësit dhe

kështu të mos i mbesim borxh as elektoratit tonë po as gjendjes në përgjithësi të Kosovës. Ju falemnderit.

**RAMADAN KELMENDI LDK**

I nderuar kryetar, të ndëruar deputetë, duke përkrahur propozimin e LDK-së dhe të gjithë të tjerëve që në rend të ditës të vihet çështja e Mitrovicës, unë duhet t'i shtroj vetëm disa çështje që kanë të bëjnë me këtë dhe atë me pikat më të shkurtëra. E para mendoj se ky Kuvend i sotshëm nuk është i pregaditur sa duhet nga Sekretari i përkohëshëm ngase kemi marrë vetë rendin e ditës pa kurfarë materiali,dhe shpresoj se në të arrdhmen nuk do të përsëritet.

E dyta nuk u aprovua rendi i ditës, dhe natyrisht me Rregulloren mbi punën e Kuvendit është parapa që delegatët kanë të drejtë të shtrojnë pyetje dhe të marrin përgjigje dhe propozoj si pikë plotësuese të jetë e përhershme kjo.

Duke u mbështetur në ate që u tha une vetëm dua të them se grupet delegatët, unë vie nga Mitrovica, deputet i Mitrovicës i LDK-së, kemi paraqitur kërkesën me shkrim me datën 10.3.2001 e cila është nënshkruar edhe nga deputetët e Skenderajt dhe të Vushtrisë dhe është dashur të ketë parasysh gjendjen faktike që ekziston në Mitrovicë, e si e tillë sot do të duhej të vehej në rend të ditës. Vetëm ne që jetojmë atje mund ta dimë se çka po ndodh, thua se Mitrovica ka mbetur anash dhe në nivelet më të larta të pushtetit qendror në Kosovë aspak nuk mendohet për këtë.

Qytetarëve të zonës veriore të Mitrovicës dhe të Kosovës veriore në tërësi, po në radhë të parë ata të Mitrovicës veriore dhe fshatrave të këtij regjioni u janë mohuar të gjitha të drejtat dhe liritë njerëzore të garantuara me Deklaratën univerzale mbi të drejtat e njeriut të vitit 48, si edhe konventat ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike 56,-tën, konventat ndëkombëtare për të drejtat ekonomike sociale politike kulturore 66-tën, Konventa internacionale për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit 66-tën, Konventa ndërkombëtare kundër torturës, krimit dhe formave tjera të degradimit njerëzor

1984-tën, Konventa internacionale mbi eliminimin e diskriminimit të gruas, fëmijëve dhe familjeve, Rezoluta 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së etj. Në pajtueshmëri me këto deklarata dhe konventa të cekura më lartë ne si qytetarët nuk i gëzojnë këtë liri dhe të drejta, të drejtën e jetës, të drejtën e lirisë, të drejtën jetës aty ku kemi lind, të drejtën e jetës të përbashkët me familje,të drejtën e pronës shtëpisë, banesës të drejtën e mbrojtjes individuale, të rituale fetare etj, të drejtën e mbledhjeve dhe tubimeve, të drejtën e lëvizjeve dhe qarkullimit të lirë të qytetarëve, korrespodencën, të drejtën e aktivitetit të lirë politik, të drejtën e punës, të dretën për jetë të qetë, të drejtën për edukim dhe arsimim, të drejten e sigurisë vetanake dhe kolektive, të drejtën e mbrojtjes shëndetësore dhe një mori të drejtash. Mbështetur në këtë që u tha dhe u ndëgjue ju lus edhe një herë që sot të vehet në rend të ditës pika e aktualitetit politik në Mitrovicë, në veçanti pas ndodhjeve të eskalimit të shovinizmit serbë në atë pjesë veriore. Ju falemnderit.

**RANDJEL NOJKIĆ KP**

Gospodine predsedavajući, dame i gospodo poslanici. Za nas je pitanje Mitrovice takođe veoma važno, i mislim da su naši članovi Predsedništvo to pitanje pokrenuli na Predsedništu no međutim dobiliste odgovor, kakav je stav po tom pitanju. Mislim da smomalo krenuli pogrešnim smerom mi smo prešli na prvoj tačku dnevnog reda, a da nismo usvojili dnevni red. U koliko se vraćamo na to pitanje već usvojenog dnevnog reda mi imamo takođe iniciativu da se u dnevnni red uvrsti i najnovi događaji koji su se desili zadnjih dana, naime juče je izvršen teroristički napad na konvoj iz Merdara prema Kosovom Polju, pre neki dan takođe napadnuti su ljudi u Lipljanu na svojim imanjima, pre 5 dana u Kovom Polju su napadnuti mladići, takođe talas nasilja je ponovo krenuo prema serbskoj zajednici, ako govorimo o proširenju dnevnog reda ja predlažem da i ovo stavimo na dnevni red. Hvala

**MUHAMET KELMENDI AAK**

Deputetë të nderuar, zonja dhe zotëri, çështja e paraqitjes e tërësisë territoriale nuk është një çështje e cila mund të të krahasohet dhe duhet të krahasohet me incidente të cilat

mund të ndodhin nëpër vise të ndryshme siç ndodhin çdo kund në botë. Veprime kriminale të dënueshme mund të ndodhin edhe ndodhin nëpër në evropën perendimore nëpër shtetet e ndryshme më të zhvilluara , dhe me demokraci më përparimtare, mirëpo çështja e tërësisë territoriale e cila është e përcaktuar qart dhe prerë në rezolutën 1244 pastaj marrë edhe e sanksionuar në Koornizën Kushtetuese ku thuhet se tërësia e territorialit të Kosovës është vend i pa ndarë, është në çështje e cila nu ka lindur dje dhe pardje është një çështje që nga lufta pas tërheqjes së forcave pushtuese serbe ka dalur si problem dhe ende deri më sot faktori ndërkombëtar nuk e ka pa si të arsyeshme ta paraqes si problem para Kuvendit të Kosovës dhe organeve tjera dhe ende nuk e ka pa të arsyeshme të merr masat e duhura për zgjidhjen e këtij problemit që sipas mendimin tim dhe të partisë që e udhëheqi është jetik për të ardhmen e këtij vendi dhe të bashkësisë në tërësi në kësaj pjese të ballkanit. Prandaj, përkrahi kërkesën e deputetëve të tri partive politike d he ë shtë e r rugës q ë n e p ara s e t ë fillojmë m e d iskutimin s iç e b ëmë, s ot t ë diskutohet rendi i punës e pastaj të merret mendimi i të gjithë deputetëve, në mënyrë që ne bashkarisht të angazhohemi në zgjedhjin e problemeve të tilla. Mirëpo, çështja nuk është vetëm e veriut të Kosovës apo edhe çështja e marrëveshjes Serbi-Maqedoni, lidhur me tri mijë hektarë tokë të cilët janë duke u dhënë qeverisë maqedone, e kemi rastin e fshatit afër të Gjilanit po ashtu ku ka pretendime territoriale nga Serbia që të jepet në fakt e kemi një skenar të përgatitur nga Beogradi i cili synon drejtë për së drejti për coptimin e Kosovës skenar të cilin ne me çdo kusht duhet të kundërshojmë dhe të mendoj se këtu është vendi ku duhet të diskutohet dhe të mirren vendime sepse në fund të fundit sipas Koornizës kushtetuese organet vetëqeverisëse të Kosovës sa edhe faktori ndërkombëtar pa patur ne të drejtë as që dëshirojmë që të futemi në kompetencat e KFOR-it , të faktorit tjetër kemi obligime juridike, kemi përgjegjësi moralo shoqërore juridike të themi fjalën tonë, dhe të angazhohemi në realizim të këtij pikësynimi.

Prandaj është e domosdoshme të shtohet kjo çështje në rend të punës.

Çështja e dytë me të cilën unë zoti kryesues dhe Kryetari i Kuvendit të Kosovës mendoj që është e domosdoshme të pregaditet një seancë e veçantë, dhe unë k am përgjegjësi morale si kryetar i Partisë së Unitetit Kombëtar sepse ish kryetari i kësaj partie M. Ukshin Hoti edhe sot e kësaj dite nuk dihet ku gjindet dhe fati i tij ndërsa ne kemi të bëjmë me 3 mijë e sa vetë të zhdukur të humbur nga Kosova dhe shqiptarë, prandaj mendoj se në

seancën e ardhëshme, Kryesia e Kuvendit të Kosovës duhet të pregaditet edhe në këtë drejtim dhe të shtroj të paraqes të një seancë të veçantë e cila për mendimin tim dhe të partisë që e udhëheqi është madhore, për të ardhmen e Kosovës. Pra mendoj që nuk duhet që të implikohen çështjet e rëndësisë dhe nuk mund të themi se skanë rëndësi të veçantë për një çështjė jashtëzakonisht e rëndësishme, duhet të përpiqemi edhe bashkërisht të ecim përpara. Mendoj se një çështje tjetër të cilin dua të shprehi mendimin tim është se Kryesia e Kuvendit të Kosovës është marrë vesh se çfarë komisione do të kemi,cilat janë ato ne nuk e dimë, ne ende si deputet nuk e kemi numrin e komisioneve, emërtimin e tyre dhe nuk dihet fare përveç rendit të punës dhe shtrohet pyetja për z. Kryetar se çfarë mund të deklarohemi ne, se çfarë mund të votojmë ne, se çfarë mund të themi ne lidhur me ktëo komisione, ndonëse për mendimin tim ka se çka do të deklarohet sepse abc-ja dhe mekanizmi kryesor hallka kryesore e ndërtimit të shoqërisë sonë dhe e funksionalitetit të Kuvendit janë pikërisht këto komisione dhe pa këto komisione pa këto mekanizma nuk mundemi të ecim përpara, prandaj luteni që me të vërtetë na jepni këto përgjigje paraprake me shkrim nën mënyrë që ne të pregaditemi të dim se çka deklarojmë të dim se kah do të ecim. Falemnderit

**DRITON LAJÇI PDK**

I nderuar Kryetar, të nderuar kolegë parlamentarë, natyrisht se këtu para nesh secili nga deputetët është duke propozuar problemet, shqetësimet të cilat edhe një pjesë dermuese pajtohemi me to, mirëpo shtrohet pyetja se a do të mundemi edhe për një seancë parlamentare t'i zgjidhim këto probleme. Natyrisht se jo. Për këtë arsye, unë edhe kur isha dje në një udhëtim kur isha aty pari po shohë nëpër rrugë aty, një djalë të ri i cili ishte i droguar totalisht i humbur! dhe e pyeta veten: A thua vallë, ku janë institucionet e Kosovës, ku jemi ne? Ne më tepër jemi të ftuar që të marrim pjesë në seminare, në tryeza se sa nga Kryesia e Parlamentit të Kosovës. Për këtë arsye kërkoj më shumë përgjegjësi nga vetë Kryesia,nga vetë Kryetari.Të jeni të bindur se ne nuk mund t'i zgjidhim të gjitha problemet sot. Për këtë arsye më shumë përgjegjësi edhe po të punojmë natën dhe ditën jemi të vonuar, i kemi 10 mijë faqe për t'i aprovuar këtu, prandaj ju lutem në emër

të gjeneratës sime më shumë përgjegjësi, më shumë rend, më shumë angazhim. Ju falemdnerit.

Urdhëroni zotëri,

**SABIT RRUSTEMI LDK**

Kryesia e punës i nderuari Kryetar, me gjithë shqetësimet që janë shfaqur këtu nga përfaqësuesit dhe parlamentarët, kërkoj që domosdo kjo duhet të mbështetet nga të gjithë deputetët dhe të shtrohet si çështje e diskutimit se jo vetëm situata në Mitrovicë dhe në veriun e Kosovës, e jo vetëm situata me marrëveshjen ilegale Maqedoni – Serbi ku janë dhënë 2500 hektarë tokë, po edhe çështja që e preokupon komunën e Gjilanit gjegjësisht lagjen e Zahirajve ku 100 hektarë të kësaj komune janë shkëputur arbritarisht dhe i jepen komunës së Preshevës - gjegjësisht Serbisë.
Këta 100 hektarë tokë, me një marrëveshje të brendshme ushtarake-teknike të Kumanovës kanë mbetur brenda zonës së sigurisë, dhe kjo ka ndikuar që me heqjen e kësaj zone kjo pjesë e komunës së Gjilanit sot ndodhet në Serbi. E dihet se që nga gjeneza këta kanë qenë banorë të komunës së Gjilanit. Unë kujtoj që keni edhe dokumentacionin gjegjës që është dorëzuar nga komuna e Gjilanit për Kuvendin e Kosovës, prandaj le të përfshihen këto të gjitha dhe të shqyrtohen seriozisht nga Kuvendi i Kosovës,sepse këtë edhe e kemi obligim. Ndërsa sa i përket shqetësimeve të deputetëve të koalicionit Kthimi se po shkelët rendi i ditës apo po keqpërdoret foltorja,ne e pamë vetë se ata ishin të rezervuar ku u ftua nga ju që ta marrin fjalën.Prandaj ishte shumë gjest i mirë i deputetit Sabri Hamitit që thjesht mos e le foltoren zbrazët dhe të kërkoj një çështje që e kërkojnë gjithë banorët e Kosovës . Ju falemnderit.

Urdhëroni zotëri

**XHEVDET NEZIRAJ IRDK**

I nderuar zoti Kryetar, të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë, përveç që bashkangjes mendimin me parafolësit e mi, do të kisha me propozu që edhe në rendin e dytë të pikës

nën dy, ku është ndryshimi kushtetues do të kisha propozuar që të bëjë edhe një ndryshim në Kornizë, ku mund të themi ne nuk ishim konsultuar fare për atë Kornizë, është se komuniteti egjiptas romë dhe hashkali janë të përfshirë si një grup, prandaj pasi që tani janë të definuar në zgjedhje, se komuniteti egjiptas ka 2 deputetë hashkali 2 dhe romë 1, këto komunitete duhet të jenë të ndara,sepse nuk po dihet se kush ken është tue përfaqësu, dhe në lidhje me Kryesi të Kuvendit nuk po dihet se çka po ndodhë prandaj do të përpiqem që të citoj akademikun e njohur tonë dhe për fat e kemi edhe kryeparlamentar z. Daci i cili në takimin e parë pat thënë; "se vështirë është të vallzosh kur kompozimin e bëjnë të tjerët". Për fat populli im dhe unë personalisht shpesh herë jam hy në valle pasi është bërë kompozimi nga të tjerët, pasi që është largu dirigjenti dhe orkestrina. Për fat tani i kemi kompozitorët, kemi dirigjentin, kemi orkenstrinën të zgjedhur, kemi dëshirë që të pyetemi edhe ne herave tjera. Ju falemnderit

**TOMË HAJDARAJ LDK**

Ju falemderit zoti kryesues, deputetë të nderuar,

Unë, pas diskutimeve që u banë nga përfaqësuesit gjegjësisht grupi parlamentar, e pashë të udhës si ekspert i bujqësis dhe lus zotin kryetar e grupin parlamentar të minoritetit serb që ta konfirmojë ministrin e Bujqësisë. Nuk e di pse nuk është konfirmuar dhe pse politizohet çështja e ministrit të bujqësisë , mos ka ndonjë vazhdë më të thellë këtu, nga vetë fakti që u diskutu deri më tash, dhe pretendimet që po bëhen rreth Kosovës për tokat bujqësore le për të kuptuar se modeomos duhet të deklarohen zotërijtë e minoritetit serbë për konfirmimin e ministrit, përndryshe çështja e bujqësisë së Kosovës nuk guxon të mbetet, sepse jemi në prag të mbjelljeve pranverore, ju e dini se prej çkafit dhe ku e ka ekzistencën popullata e Kosovës, jemi në prag të mbjelljeve andaj nuk kemi asfar rregullative ligjore edhe po qe se kemi, nese nalemi mas vitit 1989 nuk ka koment, ju lutem të insistoni edhe një herë, që njerëzit të cilët janë të përcaktuar në vendin e ministrit të bujqësisë të japin kandidatin e tyre, përndryshe atëherë do të del kjo çështje re,. Dhe përkrahi të gjitha diskutimet e parafolësve të mijë për çështjen rreth Kosovës, Mitrovicën për Gjilanin, dhe për Marrëveshjen Maqedono – Serbë për 3000 hektarë tokë.

Ju falemdnerit

Sayın başkan sayın milletvekiller

Gerçekten Parlamentonun daha hızlı biraz çalışması gerekiyor.Mitroviçadaki sorunların çözülmesi işte sınırdaki sorunların çözülmesi Parlamentoda gerçekleşmesi lazımdır.Madem ki halktan seçilmişiz halkın sorunlarını çözmeliyiz.Dolayısıyla ben de bu konuların burda tartışılası için destek veriyorum.İkinci konu 26 Martta ...Tamam...Tamam...

Sayın başkan sayın milletvekilleri bir daha

Dediğim gibi Parlamentonun çalışması daha hızlı gerekiyor boşuna bazı vakitleri kaybediyoruz .Desteğim yani hem grubumdan hem Türk toplumundan da zaten Kosova sorunlarının çözülmesi için Parlamentonun konuşması gerekiyor.Biz burda halkın oylarıyla seçilmişiz ve halkın sorunlarını burada çözmeliyiz ve dolayısıyla ben de bu konuların Parlamentoda konuşulması için destek veriyorum.İkinci konu 26 Martta işte Divan başkanlığına yani Meclis başkanlığına bir öneride bulunduk Meclisin statüsüyle yani geçici tüzüğünün değiştirilmesiyle ilgili orda deniliyor ki parlamenter grupları için muhakkak altı kişinin olması gerekiyor .Biz burda Türk toplumuna Boşnak toplumuna ve işte Rom grubu toplumuna ayrıcalık yapılarak daha az sayıda da milletvekilinin olmasını önerdik. Maalesef bugün gündemde bu geçilmemiş bunun gündeme de alınmasını istiyoruz.Ve tartışılınsın. Bu bizim bir öneridir kabul edilirse iyi kabul edilmesse yine iyi. Meclis çalışmalarına devam edebilir. Teşşekür ederim.

**BAJRAM BAJRAMI PDK**

I nderuari kryetar të nderuarë deputetë,

Mendoj se tri grupet parlamentare e arsyetuen propozimin për zgjerimin e rendit të ditës dhanë mjaft arsye. Unë mendoj që pasi që kanë kaluar 5 muaj nga mbajtja e zgjedhjeve mendoj që ka ardhur koha që institucionet e Kosovës të ushtrojnë në mënyrë më efektive përgjegjësitë e veta, mendoj që në këtë kontekst edhe Kuvendi i Kosovës që definohet organi më i lartë i vetëqeverisjes së përkohëshme duhet në mënyrë efektive të fillojë t'i realizojë kompetencat që i ka me Kornizën kushtetuese.

Nuk ka nevojë që të arsyetohet gjendja në Mitrovicë, gjendja në Gjilan dhe Marrëveshja në mes Maqedonisë dhe Kosovës. Mendoj që me këto tri akte në mënyrë flagrante dhe të drejtpërdrejtë po cenohet integriteti territorial i Kosovës, dhe për mendimin tim nuk ka asnjë çështje më aktuale dhe më prioritare se sa një diskutim politik në Kuvendin e Kosovës p ër k ëtë çështje d he m arrja e q ëndrimeve t ë c ilat p astaj d o ti m arë p ërsipër Qeveria për t'i zbatuar. Unë propozoj që mos të hapim diskutim publik dhe mos të mbajmë fjalime politike para se të vendosim për të futur këtë pikë të rendit të ditës, por të qesim drejtëpërdrejtë në vendosje vendime se a do ta zgjerojmë në rendin e ditës edhe në këtë pikë të rendit të ditës. Arsyet për të zgjeruar janë jashtëzakonisht të mëdha. jo është një çështje emergjente që nuk don shtyerje. Unë mendoj që është shtyer mjaft e kujtoj se është dashur më herët të mbahet një mbledhje e jashtëzakonshme ku të diskutohen këto çështje dhe Kuvendi i Kosovës do të merrte qendrimin zyrtar, mendoj se këtu bënë edhe një gabim procedural udhëheqësit e mbledhjes, është dashur para se të qitet rendi i ditës në votim të pyetet për aprovimin e rendit të ditës dhe në këtë kontekst propozohet kjo pikë dhe mendoj se gabimet tona do t'i mësojmë, kështu që unë propozojë që mos të bajmë diskutime mos të mbajmë fjalime politike para kohe, mendoj që çështja e Mitrovicës është një çështje që don një diskutim të gjatë dhe shumë serioz për shkak se gjendja është shumë serioze, andaj propozoj që Kuvendi përfundimisht të deklarohet për fund tërend të ditës këtë pikë të rendit të ditës, ju falemnderit

**NEXHAT DACI**

Kështu është kur gabimet janë gjithmonë - on llajn zyra e Kryetarit, Parlamentit me zyren e zotit Shtajner, zyra Kryesisë së Kuvendit me grupet parlamentare, dhe në mungesë të informatave kthyese vjen deri te kjo. Në fakt është një normë dhe një rregull në të gjitha parlamentet edhe në tonin që çështjet të fillojnë profesionalisht të diskutohen në komisione parlamentare ose në komitete parlamentare, ato propozime të sponduara mirë profesionalisht dhe politikisht të shkojnë në Kryesi të Kuvendit dhe Kryesia e Kuvendit të bënë agjendën dhe të hap çështjet të gjitha që janë me rëndësi Asnjë çështja nuk është paramenduar të mëshifet nga Kuvendi, unë vazhdimisht e them se Kuvendi është një institucion i lirë, sipas të gjitha dokumenteve, prandaj z. deputetë

unë po ju them me përgjegjësi se Kryesia e Kuvendit ende nuk i ka në përgjigjet e të gjitha grupeve parlamentare për emrin e udhëheqësve të Komiteteve , zëvendës udhëheqësve dhe anëtarëve, Unë nuk dua të kërkoj falje kur në Parlament, nuk guxon të lëshohet lëshim që të mos ta ken deputetët materialin komplet para mbledhjes, dhe kjo vazhdimisht i nsistohet, k omitetet ë shtë m endur dhe p regaditur v etëm k omitetet e r eja nënkuptohet të gjitha ministritë dhe vetë ministritë kanë komitetet përkatëse që i mbulojnë ose komisionet dhe 6 komisione tjera .

T'ju informojë dy, kuvendet komunale zyrtarisht janë drejtuar për çështjen e kufijve Kuvendi Komunal i Vitisë dhe i Pejës dhe është përcjell materiali me konstutuimin e Komitetit përkatës që të studiohet dhe të vjen në rend dite të Parlamentit, nuk ka tema për të cilat nuk duhet t'i debatoj Parlamenti në qoftëse doni në mënyrë kështu të pa pregaditur unë ta hapim dhe votojmë pse të mos e shtrojmë në rend dite dhe debatojmë gjithë ditën pa pregaditur ndonjë propozim të pregaditur pa pas ndonjë propozim për çka dojmë për secilin çështje, Një çështje tjetër, në Kryesi të Kuvendit janë grupet parlamentare të përfaqësuara dhe ndoshta do të jetë ma mir që të ket shum ma mir kontakte në mes të gjithë neve nuk e heqi asnjë përgjegjësi timen në këte, rendi është që sot ti themelomë komitetet në qoftëse jeni të mendimit të kompletojmë ato dhe të fillojmë dhe të punojmë ashtu si na ka hije. Për ndryshe në qoftëse dëshirojmë vetëm me debatu pse jo, unë nuk jam adhurues i rrugëve të pa pregaditura por është e drejtë e Parlamentit të vendosë në qoftëse dëshironi ta veni në rendin e ditës çështjen e e kufijve çështjen e Kosovës në veri të sajë pse jo, asnjë propozim tjetër nuk ka arritur në Kryesi të Kuvendit për agjendën për rendin e ditës të Parlamentit, urdhëroni z. Sabri Hamiti,

**SABRI HAMITI**

Unë kujtoj që kjo mund të zgjidhet shumë në mënyrë parlamentare dhe të pranueshme të ne v otojmë q ë k jo p ikë e r endit t ë d itës t ë h yjë në s eancën e s otme d he t ë v azhdohet seanca në mënyrë tjetër, ne kërkojmë që kjo të hy në rend të ditës dhe të bisedohet për temën që është shumë e madhe me një vazhdim shumë të shpejtë të Parlamentit .Ky është propozimi, ju falemnderti.

**HAJREDIN KUQI, PDK-së**

I nderuar Kryetar, të nderuar deputetë,

Propozimi i kryetarit të grupit Parlamentar të LDK-së edhe pse nuk i preferojë thirjet kështu që jam deputet i LDK i PDK unë jam deputet i Kuvendit të Kosovës, sikur gjithë ju të tjerët, Mendoj që sot çështja e Mitrovicës edhe së para pëlqej kolegun tim Ramadan Kelmendi që tha vetëm ata që janë nga Mitrovica e din saktësisht mendoj që gjithë e çështjen e Mitrovicës, të gjithë e ndien njësoj dikush mund ta ndien edhe nga aspekti familjar, por nga aspekti emocional,por obligimin kombëtar si deputet e kemi të gjithë të interesohemi në mënyrë të njejtë, nuk ka nevoj të mblidhet ndonjë grup i veçantë se asnjë grup nuk është më kompetent se sa Kuvendi i Kosovës të diskutojë për këtë çështje dhe mendoj se diskutimi i kësaj çështje sot ka vend ka hapsirë ka mundësi por ka edhe njerëz që mund ta bëjnë një gjë të tillë, diskutimi ynë duhet të jetë diskutim përmbajtësorë mendoj që deputetët e Kuvendit të gjithë jemi të njohur me zhvillimin që bëhet atje kam përvoj të hidhur personalisht së bashku me ju me seancat parlamentare që mund të shtyhen mbi një muajë, une përveç dy propozimeve paraprake që ishte diskutimi për Mitrovicën dhe për marrëveshjen RFJ-Maqedoni kam edhe një propozim tjetër. Të gjithë e dini se me 11 mars të këtij viti z. Shtajner ishte një udhëtim zyrtar në Bruksel, dhe aty e keni vërejtur se temë shumë e veçantë e ditës ka qenë krimi i organizuar në Kosovë. Dhe unë mendoj se në një të ardhme të afërt në senancën e ardhshme të ftohet z. Shtajner, apo të ftohet edhe gjenerali Valenten pasi që organet tjera të Kosovës nuk janë komptente për sigurinë në Kosovë, ta japin një raport para këtij Kuvendi, edhe në qoftë se dikush edhe në NATO në Bruksel thotë se ka një krim të organizuar nuk është e arsyeshme që Kuvendi i Kosovës mos ta diskutojë këtë ta japë mendimin e vetë, qoftëse dikush para dy dite ndëgjoj që thotë se 1000 mijë vetura në Kosovë se janë të vjedhura dhe Kuvendi i Kosovës nuk e jep mendimin për këtë, mendoj se kemi aq shumë çështje çështje fatkeqësisht nuk janë vetëm organe që na shtyejnë me nxjerrë akte juridike por edhe të marrin vendime të cilën nuk presin të shtyhen për një tardhme të afërt. Kam edhe një vërejtje sa i përket qëndrimit të institucioneve të Kosovës në ketë rast mendoj edhe kryetarit të Kosovës, kryeparlamentit po edhe të Qeverisë.

Vërejtja ime personale është me përfaqësimin e tyre për qendrime apo për çështje të ndieshme. Mendoj që Kuvendi i Kosovës është ai që jep pëlqimin, e jep ratifikimin kundërshtimin ose diçka tjetër për marrëveshjen Serbi – Maqedoni e jo kryetari i Kosovës, jo kryetari i Parlamentit e jo kryetari i Qeverisë, dhe ata nuk mund të thonë është e pranueshme apo e papranueshme.Shkojnë në rrugën e tonë apo në rrugën e tyre, është ky Kuvend unë e ndiej veten të përgjegjshëm së bashku me ju që të jepni një mendim të tillë refuzues apo pranues. Në anën tjetër mendoj se ky Kuvend ka obligim më shumë të kërkoj përgjegjësi nga organet dhe nga institucionet tona. Une e di që jemi në fazën e parë të organizimit parlamentar por nuk mund ta kuptoj sot e kësaj dite pse ne pjesën si të thuesh apo ballinën e Kuvendit të Kosovës ende nuk ulen anëtarët e Kryesisë së Kuvendit të Kosovës. I respektojë zotërinjtë ndërkombëtarët, por për këtë Kuvend mendoj se kemi kompetença të plota për udhëheqim, e dim plotësisht që vendimet tona mund të kundërshtohen nga ta, por nuk e urej as që e kam mërzi praninë e tyre, por megjithatë kam dëshirë që Kuvendi ynë që nga hyrja deri në përfundim të punës së tij ti respektoj dhe ta ketë formalitetin e duhur. Ju falemnderit.

**OLIVER IVANOVIČ**

Nisam uspeo da zaključim da li je dnevni red usvojen ili da krećemo sa prve tačkom ali ću reći nešto što je evidentno..

Svi smo se nakupili energije za vreme ove pauze koja je trajala rekao bih, parlamentarne krize kako je neki zovu, i tu energiju pokušavamo da potrošimo danas.Moja sugestija je da sačuvamo tu energiju, ovo će jako dugo trajati. Postoje mnoga pitanja koja treba zajednički da rešavamo, i sugerišem da na početku svakako rešavamo pitanja koja će animirati sve članove Skupštine da zajednički deljujemo, da makar kroz pitanja koja možda nisu tako velike važnosti .Uključimo i one koji će se sigurno možda suprostavljati nekim pitanjima koja su najteža. Mi smo spomenuli pitanje Mitrovice, to je sigurno jedno pitanje koje će doći na dnevni red. Ja sam mišljenja da to nije pitanje za prvu našu radnu sednicu , jer Mitrovica nije izolovano pitanje, ona je jednako problematićno pitanje kao što je Priština, Gnjilane ili Peć, ta pitanja i ti gradovi imaju nešto zajednićko a ja Mitrovicu ocenjujem kao konsekvenciju jednog stanja koje je neprihvatljivo to se

bojim da otvarajući tako brzo i nepripremljeno dočićemo u sitaciji da razgovaramo zašto je Mitrovica to što jeste. Uzgred moram da Vam kažem da je Mitrovica problem za sve nas, osećamo kao problem svaki sa svoje strane svi drugaćije tumačimo taj problem, ali da svi činimo napore da se taj problem razreši tako da i severni i južni deo grada budu mirni, i rekao bih da se stvore uslovi i klima da se u njima može mirno i normalno živeti .Da malo poboljšamo svoje uslove života. Vas to interesuje iz političkih razloga , nas to interesuje iz životnih razloga ,i mislim da ako pravite redosled po važnosti da, u svakom slućaju naše egzistencialne razloge stavite u napred, bez obzira što smo druge nacionalosti mislim da ovde kao što malo pre neko reče treba da počnemo da razmišljamo kao poslanici Skupštine a ne kao pripadnici pojedinih grupa. Možda je to malo i suviše idealistički kako mi postavljamo, nečemo ići dalje, nečemo uspeti ni u procesu integracije. Ukoliko u startu imate takve stavove možete samo zaoštriti razloge i na kraju iskoristim priliku da kažemo da mi imamo svoje nekakve stavove normalne i nastojimo da situaciju u Mitrovici smirimo, a ja vas molim da pomognete u tome time što nas nečete gurnuti na drugu stranu, da budemo suprostavljeni. Slažemo se da pitanje Mitrovice postavljamo na nekoj narednoj sednici u onoj proceduri koja ide, složiću se sa primedbom da Predsedništvo nije uradilo svoj posao kako valja. Ja to sebi isto kažem ,ali isto tako ču se složiti i sa objašnjenjem koje je dao Predsednik Skupštine. A to je da još uvek postojimo pod dosta na nenormalnim uslovima. Ako mogu ja bi se osvrnuo na prvoj tački ako dozvolite da govorimo. Hvala.

**NEXHAT DACI**

Unë mendoj, që kemi edhe propozime konkrete ju lutem.

Unë mendoj që mund ta mbajmë një mbledhje të veçantë me një pikë e veçantë e cila do tu kushtohet të gjitha atyre çështjeve. Edhe nuk kemi ma arsye me i zgjatë. Sa mirë është kur po ndëgjoj që kurkush nuk po merr përgjegjësi, kurkush nuk po thotë që tri mbledhje të Kryesisë janë humbur tri javë, vetëm të kenë një rezultat dhe një mënyrë profesionale mund të punojmë, megjithatë ju falemnderit, sepse kritikat janë gjithmonë të mirëseardhura ,dhe i përmirësojnë cilësinë e punës, prandaj mendoj që të aprovojmë në rend të ditës, por jo në këtë mbledhje ta përkrahim propozimin e Z. Hamitit që të gjitha

këto çështje të hynë në rendin e ditës. Sot nuk e besoj që të mund të kemi një rezultat të përgatitur prandaj a kemi nevojë të votojmë apo të pajtohemi që të jetë në rendin e ditës të mbledhjes së parë të ardhshme,

**JAKUP KRASNIQI**

Z. kryetar, z. deputetë,

Vërtet nga aftësia e punës së Kuvendit, na ka bërë që sot ta zgjasim shumë rreth rendit të ditës pasi që çështja që u shtrua nga delegatët e LDK-së por edhe nga deputetet e subjekteve tjera politike, hyn në rend të ditës, po pasi e kemi një praktikë të hidhur të punës të Kuvendit deri më tani, unë kërkoj që kjo çështje të hynë në rend të ditës që sot të caktohet data e mbajtjes e seancës debatuese për çështjen që është shtruar,

**NEKIBE KELMENDI LDK**

(Nuk është ndëgjuar në fillim nuk i ka bërë mikrofoni) Që është pikë plotësuese e rendit të ditës, për këtë problem të diskutohet në vazhdim të kësaj senace e vazhimin e kësaj seance le ta caktoj Kryesia e këtij Kuvendi. Ju falemderit.

**GANI PREKOPUCA LDK**

Parlamentar të ndëruar, Kryesi e nderuar, jam dakord që është shtruar kjo pyetje sot, por jam në dakord edhe me ate që tha përfaqësuesi se kjo kërkon një përgatitje serioze, këtu duhet të marrin pjesë të gjithë ata që janë relevant në Kosovë, duke filluar prej KFOR-it, UNMIK-ut dhe Kryesisë së Parlamentit. Duhet material i bollshëm për të mundur ne të debatojmë në mënyrë të sinqertë prandaj kisha k ërkur jo të vazhdojmë, por të jetë një pikë e veçantë një mbledhje e veçantë urgjente që do të debaton Parlamenti i Kosovës për këto çështje kishte me qenë e udhës jam dakord që të përgatiten si duhet materialet edhe të kemi për çka të flasim secili prej nesh. Ju falemderit

Kryetari

**NEXHAT DACI**

Kohën e mbajtjes së seancës së ardhshme e cakton Kryesia e Parlamentit, rendin e ditës gjithashtu Kryesia, prandaj në momentin që të pregaditeni, do ta keni në rend ditës sepse është diskutu edhe në mbledhjen e Kryesisë, nuk është asgjë e r e, nuk d o të mëshefet asgjë në qoftë se mendoni që sot duhet ta aprovojmë rendin e ditës për një mbledhje të ardhshme ashtu siç insiston z,.Kelmendi nuk i prish punë Parlamentit, por pse mos ti lihet Kryesisë. z. Kelmendi cili është interpretimi juridik i saj?
(ajo flet prej vendit nuk ndëgjohet) Ju falemdnerit,
a jeni dakord për te a ka dikush kundër.

**OLIVER IVANOVIQ**

Na žalost ja sam jedan od retkih koji je potpuno razumeo g. Kelmendija. Drugi nisu uopšte imali prevod, jer oni sa mesta nemaju prevod.To mora da je odavde, a druga stvar ja imam drugačije mišljenje, ukoliko ovu tačku dnevnog reda ubacite u dnevni red i sednicu prekinemo kad bude ona došla na dnevni red to će defakto biti prekinuta sednica, i mi možemo sledeću s ednicu o držiti s amo u n astavku o ve p redhodne. M oj predlog je da ne stavljamo to na dnevni red danas. Dajte predlog Predsedništvu na redovan put ne zaslužuje posebnu ekstra hitnost i da Predsedništvo o tome odluči.
Tu je većina, sigurno dva člana Predsedništva srpske zajednice neče moči da preće da je stavimo na dnevni red, znači da to ne bude prva sednica u to slučaju bi možda prvu sednicu morati prekinuti i nastaviti tek posle druge sednice. Mislim da to ne bi bilo u redu. Ja vas molim u budače da ne prekinete mikrofona jer oni nemaju prevoda. Hvala

Kryetari

**NEXHAT DACI**

Unë mendoj që është votuar në rend të ditës, prandaj kur të vie në shqyrtim do të thotë është fut në rend të ditës kur Kryesia do ta shqyrton, unë mendoj që sot duhet të procedojmë me rendin e ditës të cilin e kemi marrë., prandaj edhe një herë po e përsëris ftoj përfaqësuesin e Koalicionit Kthimi a janë të gatshëm që ta propozojnë emrin për ministrin e bujqësisë.

**OLIVER IVANOVIQ**

Ja vas molim da glasate o tome, to ne možete tek tako, mi nismo dobili informacije o tome šta treba da uradimo, ja vam kažem predlog je bio sa mesta, nisu razumeli šta je vaša sugestija, ja mislim da glasamo o tome i da vidimo šta je stav koalicije.Hvala

**NEXHAT DACI**

Mirë, edhe një herë kush është për propozimin që në rend të ditës së seancës së sotit të shqyrtohen çështjet që u diskutuan, çështja e veriut të Kosovës, çështja e kufijve, çështja e sigurisë në përgjithësi, kusht është pro? Numroni ju lutem,ju lutem kush është kundër propozimit, numroni ju lutem.a ka dikush që abstenon, rezultati i votimeve është 86 për të futur në rend ditës dhe konsiderohet si çështje e aprovuar, kundër janë 15 vota, nuk ka abstenuar askush prandaj konsiderohet se është futur në rend dite për shqyrtim.

**URDHËRONI Z. NOJKIQ**

Gospodine predsedavajuči, ja želim vama da stavim jednu primendbu, i hoču da budem zaista da ne budem grub i da ne budem oštar da vrlo blago da vam uputim jednu jer ne znam i ja kako da izrazim ja sam predložio nešto u dnevnom redu ali vi niste hteli da date na glasanje ovaj je jedan veoma težak incident, po meni kršenje ljudskih prava, i prava poslanika,

**NEXHAT DACI**

Demokraci ka edhe këto çështje, prandaj vazhdojmë, lus përfaqësuesin e grupit Kthimi Parlamentar a janë të gatshëm të propozojnë emrin e Ministri për Art e Kulturë.

**Z. IVANOVIĆ**

Pre nego što odgovorim na ovo pitanje, hoču da kažem da smo mi ovde svi jednaki,ako baš tako ne izgleda, svaki predlog mora biti odbaćen ili prihvaćen ja vas molim da ta ko

ne reagujete jer to pokazujete da nas ne cenite jednako kao što cenite vaše kolege kao što G. Nojkić rekao on ima pravo da izrazi svoj predlogi da predloge mogu biti odbaćeni samo glasanjem odnosno većinom v ašim glasovima ja ne sumnjam da bi bio odbaćen morate da poštujete tu proceduru oko pitanja predloga naše za ministarstvo za poljoprivredu i šumarstvo i rularni razvoj mi vodimo ozbiljne konsultacije oko tog postoji opredeljenje u srpskoj koaliciji uopšte u srpskoj zajednici da to mesto bude prihvaćeno ali želimo za takvo mesto predložimo kompetentnu ličnost to traži odredjeno vreme i verujem u najskorije vreme verovatno za sledeću sednicu imati predloženog kandidata . Neka ovo ostane ovako to je naša sugestija, u ostalom a kako je počelo nije isključeno da ćete vi glasati drugačije. Ju falemnderit

**NEXHAT DACI**

Ju lutem nuk ka debat, nuk ju kam dhënë fjalën,

**GANI PREKOPUCA**

Më falni, moskompletimi i Qeverisë, moskompletimi i Kryesisë, moskompletimi i Sekretariatit, moskompletimi funksionimi i Parlamentit, ç'është kjo. Sa duhet të pritet që t'i kemi që ta propozojmë një ministër, le ta propozon zëvendësin e le të kryhen punët. Ministri kur të caktohet nuk ka problem, por Ministria duhet të jetë e kompletuar ju lutem. A ka kush që mua më jep përgjigje se nuk po mund të gjendet një njeri që do të jetë adekuat Ministër i Bujqësisë.Ju falemnderit.

**NEXHAT DACI**

Z. Ivanoviq e tha mirë i duhet përgatitje për të gjetur njeri adekuat. Kanë probleme, prandaj duhet të kemi mirëkuptim, Qeveria do t'i kryej punët e veta sigurisht nuk do të ndalet. E kemi formimin e Komitetit edhe për çështjet e bujqësisë. Ne do t'i kryejmë punët tona, prandaj ju lutemi për më tepër mirëkuptim.

Kthehemi në pikën e dytë të rendit të ditës.

Kemi mocionin për ndryshimin e Kornizës Kushtetuese, për të lejuar një anëtar shtesë në Kryesinë e Kuvendit, e besoj që e keni të shkruar. A e keni në rend të ditës. Unë besoj se po të gjithë. Propozohet në përputhje me nenin 14/3 të Kornizës Kushtetuese. Kuvendi i Kosovës kërkon të bëhet ndryshimi në nenin 9,1, 7 për Kryesinë e Kuvendit, t'i shtohet një paragraf i ri një anëtare mbrohet nga partia ose kualicioni që ka marrë numrin e 4-të më të madh të votave në zgjedhje për Kuvend dhe pastaj rinumrimi i paragrafeve ç-d dhe d-e me, me që është çështje që hynë dhe prekë ndryshimin e Kornizës Kushtetuese, duhet ta çesim propozimin në votim dhe duhet t'i ketë dy të tretat që të fitojë. Prandaj, pyes Kuvendin kush është për këtë propozim, të çon dorën,

**URDHËRO Z. KELMENDI**
**NEKIBE KELMENDI**

Z. kryetar, ne sot në vazhdim të punës së këtij Kuvendi hymë në një procedurë të ndryshimeve të Kornizës Kushtetuese për vetëqeverisjen e përkohshme të Kosovës. Nuk e kemi pritur që do të mbahet kaq herët ky ndryshim, por rethanat janë të atilla që e kanë imponuar edhe një ndryshim të tillë. Në këtë kontekst, unë vetëm do t'ju përkujtoja se neni 9, pika 1.7 i Kornizës Kushtetuese, parasheh, që numri i anëtarëve të Kryesisë të jetë tek jo qiftë për të marrë vendime Kryesia, me shumicë të votave, ndërkaq me aprovimin e këtij ndryshimi dhe me futjen e vetëm një anëtari të ri në Kryesinë e Kuvendit, po arrinte një numër qift, kjo ishte një arsye. Arsyeja tjetër pasi që veç po ndërrohet kjo pikë e Kornizës së Kushtetuese, atëhere mendoj se duhet të plotësohet dhe të bëhet se, Kuvendi ka një Kryesi të përbërë prej 9 deputetëve të Kuvendit dhe të shtohet edhe një anëtar i Kryesisë së Kuvendit nga rradha e deputetëve të Lidhjes Demokratike të Kosovës, kështu që LDK-ja të ketë tre anëtarë të Kryesisë së Kuvendit, sepse në këtë mënyrë grupi parlamentar i Kosovës i LDK-së mendon se do të respektohet edhe vota e popullit do të aplikohet edhe përfaqësimi i përafërt në Kryesinë e Kuvendit dhe to të ruhet parimi i cili është një mekanizëm për votim , parimi i numrit tek të përbërjes së Kryesisë së Kuvendit. Ju falemnderit.

**MUHAREM KELMENDI**

Natyrisht edhe unë në fillim do të reagoj ndaj termave jozyrtare në këtë Parlament dhe lus kryetarin e Kuvendit që tani e tutje mos të lejojë terma jozyrtare për Kosovën. Emërtimi zyrtar është Kosovë. Edhe me Rezolutën edhe me Kornizën Kushtetuese. Duhet njëherë e përgjithmonë të ndërpritet ky efendim, duke përdorur terma jozyrtar sa i përket emërtimit të Kosovës. Unë kam një vërejtje. Shumica e deputetëve që nuk kanë asnjë material këtu rreth këtyre komisioneve, nuk di pse po ngel kjo çështje. Mendoj se kjo çështje, formimi i këtyre komisoneve është një akt shumë i rëndësishëm për efektivitetin dhe funksionalitetin e këtij Kuvendi. Unë mendoj se këtu jemi vonuar mjaft por lus Kryesinë e Kuvendit që të marë masa sa më të shpejta që këto të vihen në funksion dhe të filloj Kuvendi ta kryej punën edhe për të cilën egziston pra të fillojë proçesin e ligjdhënies.

Pra, do të ndalem vetëm në kontestimet që kolegu Saviq bëri rreth formimit të dy komisioneve. Komisioni për marrëdhënie me jashtë dhe Komisioni për çështje emergjente. Mendoj se këto kontestime nuk janë valide meqenëse Kosova në bazë të Kornizës Kushtetuese ka ingjirenca në sferën e bashkimit me jashtë. Ato ingjirenca janë te Kuvendi i Kosovës, te Qeveria e Kosovës, te kryetari i Kosovës. Është fakt se ato kompetenca nuk janë të plota, janë të kufizuara më shumë kompetenca të rezervuara të përfaqësuesit special, por brenda atyre kompetenca që i njihen Kosovës me Kornizën Kushtetuese unë mendoj se është i nevojshëm një komision parlamentar i cili do të pregaditë për Kuvendin e Kosovës çështjet nga kjo sferë. E njejta çështje vlenë edhe për

komisionin e sigurisë dhe çështjet emergjente edhe në këtë fushë është një fushë ku institucionet e Kosovës kanë një përgjegjësi të kufizuara ka disa kompetenca të institucioneve të Kosovës dhe mendoj se formimi i një komisioni të veçantë është shumë i arsyeshëm dhe do të ndihmonte koncipimin e politikës së Kuvendit të Kosovës rreth kësaj fushe.Ajo që më ka ra në sy megjithëse materiale s'kemi askush mungesa e një komisioni që është i rëndomtë për çdo Kuvend është një komision që quhet komisioni për madatet dhe imunitet, meqenëse pranë çdo Kuvendi ekziston një komision i tillë. Unë mendoj se edhe Kuvendi i Kosovës duhet ta ketë një komision që quhet për mandate dhe imunitet, meqenëse pranë çdo Kuvendi ekziston një komision i tillë. Unë mendoj që edhe Kuvendi i Kosovës duhet ta ketë një komision për imunitete dhe mandate në qoftëse numri tani është limituar atëhere mund të merremi vesh se këto punë mund t'i bashkangjiten një komisioni tjetër, që është më i përafërt, këtë rast komisioneve për çështje ligjore .Ne të mos prejudikojmë që mundemi një periudhë të ardhshme të mos kemi çështje të imuniteteve dhe mandateve. Është e nevojshme që për ketë të kemi një komision parlamentar apo ta autorizojmë një komision ekzistues nga këto 16 komisione që ai të merret me këto çështje. Ju falemnderit

**SABIT RRUSTEMI LDK**

Z. kryetar po flasë më shumë në bazë të asaj që jam informuar nga shtypi dhe mediat rreth komisioneve parlamentare me që u tha edhe nga të tjerët nuk i kemi materialet. Ne e dimë vetëm për ato komisione të cilat si grup parlamentar kemi dhënë kontributin tonë që u përmend.

Nga 16 komisionet që po thonë se janë formuar, unë jam i informuar nëpërmes shtypit për mungesën e një komisioni për mendimin tim që do të duhej të jetë patjetër në punët tona si kuvendar. Është fjala për komisionin për media dhe shtypin, një komision që do ta nxiste dhe do ta ndihmonte punën e mediave dhe shtypit këtu në Kosovë. Pavarësisht se këtë komision e kemi tash jashtë Kuvendit të Kosovës më shumë janë në komptencat e UNMIK-ut dhe OSBE-së se ata një ditë nuk do të jenë këtu, dhe ne si kuvendar, patjetër duhet të miremi me këtë çështje. E kemi fatin e pazgjidhur të "Rilindjes" një gazetë me

traditë të gjatë në Kosovë dhe pastaj edhe të Radio - Televizionit të Kosovës që përmes këtij komisioni do të kishin gjetë më tepër një mbështetje. Prandaj, lus që Kryesia e Kuvendnit të ketë parasysh këtë dhe natyrisht të jetë ndihmesa e deputetëve në këtë drejtim. Ju falemnderit

**RANDJEL NOJKIĆ KP**

Dame i gospodo,

Ja bih se opet pozvao na dokumenta koja su međunarodno priznata i sa kojima ćemo se, nadam se, i mi ovde složiti. To su Privremeni poslovik Skupštine Kosova i Ustavni okvir odnosno Uredbu 2001/19. U Privremenom poslovniku Skupštine stoji veoma jasno pravilo 6.2 koje pitanja ne mogu da se stave na dnevni red Skupštine jer nisu u nadležnosti Skupštine. Prema ovom Ustavnom okviru zna se koje su nadležnosti specijalnog predstavnika Generalnog sekretara Ujedinjenih Nacija, a Povelja 8 Ustavnog okvira vrlo jasno demantuje ono što je ovde potvrđeno, odnosno da su odbori pod rednim brojem 15 i 16, to je Odbor za međunardnu saradnju i Odbor za finansije isključivo u nadležnosti koje su rezervisane za specijalnog predstavnika Generalnog sekretara i to pod tačkom c zatim tačkom o i ono što malo pre g. Savić koji kaže da mu nije bilo jasno. Ja ću mu reći vrlo jasno u tački gde stoji da su upravo bezbeznost i pripravnos za vanredne situacije apsolutno rezervisani za specialnog predstavnika generalnog sekretara. Smatram da se na taj način krši i Poslovnik i Ustavni okvir i nešto što bih ja takođe inicirao, inicirao bih upravo zato što sam u protekloj godini i nekoliko dana pre formiranja ove Skupštine bila je radna grupa za nestala i pritvorena lica i moram da vam kažem da je ta grupa radila dosta dugo. Inicijativa je bila pred izbore da upravo ta grupa inicira da se formira Skupštinski odbor koji će se baviti ovim pitanjima. Mnogo je razloga zbog čega smatramo veoma bitnim da se pri Skupštini formira odbor za nestala, kidnopavana i pritvorena lica s obzirom da je jedan proces veoma dug i veoma ozbiljan, pred ovom Skupštinom i uopšte pred društvom tako da smatram i predlažem da se formira ovaj odbor.

**MUHAMET KELMENDI**

Zoti kryetar, deputetë të nderuar.

Nuk e di, ndoshta grupet parlamentare të tri partive të mëdha dhe të "Kthimit" i kanë numrin e ndëgjuem edhe sot 16 për llojin te komisioneve. Me të tjerët nuk kemi marrë, përveç llojit të punës. Nuk dimë çfare qfarë komisione ka prandaj është shumë vështirë që të shprehim mendime konkrete se cilat komisione ose të përkrahim këtë afat të komisionit sepse nuk e kemi fare, Duhet të jet një çështje për të cilën mendoj unë, Kryesia e Kuvendit të Kosovës dhe drejtëpërdrejt z. kryetar e keni për detyrë të kujdeseni që materiali paraprakisht t'i dërgohet çdo deputeti, jo vetëm grupeve parlamentare, por çdo deputeti, në mënyrë që të ketë kohë për tu përgatitur në shtëpi dhe për të ardhur këtu, për t'i shprehur mendimet se çka mendon ai lidhur për çështjet lidhur me punën. Megjithate, unë do të shprehi mendimin tim për disa çështje për të cilat u paraqitën këtu pa ditur sepse nuk e di llojin e komisioneve të cilat është planifikuar të propozohen nga Kryesia për t'u zgjedhur këtu. Nga Korniza Kushtetuese dhe fushëveprimtaritë të cilat janë të rezervuara,janë të përcaktuara për institucionet e përkohëshme vetëqeverisëse të Kosovës dhe pastaj të ndara bashkarisht me faktorin ndërkombëtar dhe të rezervuara, del se shumë komisione, ka mundësi ,përveç atyre ministrive të cilat ne i kemi të përcaktuara dhe rrjedhimisht komisionet e njejta i kemi edhe komisionet e tjera të cilat duhet t'i shërbejnë këtij Kuvendi për funksionim normal. Mekanizmi kryesor i Kuvendit, për të mundur t'i kryej detyrat, e veta për të ecur përpara, janë komisionet. Nëpër komisione shqyrtohen çështjet, përgatitet materiali, dërgohen në Kuvend, shqyrtohen dhe pastaj bëhen vendimet e Kuvendit. Megjithate dua t'i përmendi disa çështje të cilat u thanë këtu. Çështja e marrëdhënieve me jashtë.

Ne kemi pasur mundësi dhe kjo çështje është jashtëzakonisht e caktuar mirë dhe qartë me Kornizën Kushtetuese. Institucionet vetëqeverisëse të Kosovës kanë kompetenca nga fushëveprimtaria e vetë për të dalur në raport me faktorin e jashtëm, dhe shtrohet pyetja pse mos të kemi ne një komision në kuadër të këtij Kuvendi, i cili do të analizojë këto çështje, dhe të del me informacione kohëpaskohe dhe do ti ndihmojë këtij Kuvendi në drejtim të dhënies të informacioneve të qarta dhe të çështjeve tjera nga kjo fushë . Une

shkoj edhe më thellë, jo vetëm të sigurisë dhe emergjencës, siç është quajtur këtu çka ndëgjova se Jam i mendimit se duhet të kemi një komision drejtëpërdrejt të çështjeve të sigurisë. Fjala e punëve të brendshme, si quhet çdo kund nëpër botë dhe çështjes së mbrojtjes. I thamë këtu me qëllime të caktuara, jo për të ndërhyrë ne faktorit ndërkombëtar KFOR-it dhe përfaqësuesit special, të sekretarit të përgjithshëm ose policisë së UNMIK-ut me kompetencat e veta, të cilat i ka, por ky Kuvend e ka për detyrë duhet domosdo t'i ketë informacionet e drejtëpërdrejta me fushën e sigurisë, në fushën e cenimit territorial të cilën e sot e debatuem me orë të tëra këtu.

Prandaj, në fushën e mbrojtjes, duhet të ketë informacion edhe në fushën e rendit të drejtpërdrejtë të punëve të brendshme, sepse ne kemi 4000 anëtarë të cilët janë në Shërbimin Policor të Kosovës. Me keto komisione ne fare nuk ndërhymë në punën me kompetentet të cilat i ka faktori ndërkombëtar, përkundrazi i ndihmojmë atij faktori në drejtim të kryerjes së detyrave sa më mirë. Ne nuk kemi nevojë të informohemi këtu nëpërmes gazetave, nëpërmes radio dhe televizioneve se çka po ndodhë në fushën e rendit, çka po ndodhë në fushat e tjera Komisionet do të ishin ato që drejtëpërsëdrejti do të informonin dhe natyrisht Kuvendi do të debatonte dhe nxirrte qëndrimet të cilat janë të domosdoshme për t'i nxjerrur. Një çështje tjetër për të cilën unë mendoj së është shumë e domosdoshme, gjë që pajtohemi me propozimet për mandate dhe ankesa ose për imunitetet turke, egziston një komision i veçantë. Unë shprehi mendimin tim të rezervuar, jo pse jam kundër atij komisioni, por mendoj se është të bëhet një super komision. Është fjala për punë dhe çështje juridike ligjore dhe kushtetuese. Është një komision, i cili për mendimin tim shumë komisione tjera mund t'i lëmë siç është turizmi, sepse turizmi ose bujqësisë mund t'i bëjmë edhe ato natyrisht mund t'i krijojnë edhe ato por në qofse i marim këto tri fusha jashtëzakonisht të rëndësishme sipas Kornizës Kushtetuese dhe detyrave të mëdha që shtrohen në këto tri fusha z. Kryetar, për mendimin tim që të ndahen këto tri çështje në tri komisione të veçanta, në çështje juridike ne nuk kemi ministri të drejtësisë, i cili natyrisht është një fushë jashtëzakonisht e gjërë dhe duhet të kemi një komision të veçantë që merret me këte. Me çështjen legjislative, ne nuk kemi fare ligje. Ne udhëheqemi nga rregulloret e veçanta të UNMIK-ut dhe ligjet e ndryshme të cilat kanë qenë në fuqi në ish RF të Jugosllavisë deri me 1 janar 1989-tës.Ky Kuvend duhet të përgatit ligje, të përgatit projekte, e në qoftëse ne tani

ia japim këtij komisioni se përveç çështjeve juridike dhe të ketë çështjeve legjislative kushtetuese dhe do të ketë shumë vështirë t'i kryej këto detyra. Prandaj, mendoj se është e rrugës të ndahen në tri komisione të veçanta, e në fund i bashkohem idesë së z. Arsim dhe të tjerëve këtu, se sipas Kornizës së Kushtetutës të Rezolutës e ka një emër kjo është KOSOVË e s'është Kosovë e Metohi. Edhe në rezolutë e në Kornizë, z. kryetar ju kujtohet disa herë na keni ndalë fjalën, edhe në të kaluarën e keni për detyrë për të ndalë në qoftëse nuk respektohet ligjshmëria në Kosovë. Ju falemnderit.

**FATMIR LIMAJ PDK**

Unë pajtohem dhe mbështes propozimin e kryetarit të Kuvendit rreth emërave që parashtruen grupet parlamentare dhe duhet të shkojë në votim. Nuk dua që t'i përsëris fjalët që kanë thënë të tjerët duke i mbështetur, por desha ta ngris edhe një çështje shumë të rëndësishme.Mendoj që sot ne duhet ta ngrisim një komision të veçantë për nxjerrjen e rregullores së këtij Kuvendi. Kjo është punë urgjente për mendimin tim, për të punuar ky Kuvend. Ne ende punojmë me një rregullore e cila nuk është miratuar në këtë Kuvend. Është nga përfaqësuesi i Sekretarit të Përëgjithshëm dhe mendoj që Kuvendi i Kosovës tash duhet ta nxjerrë rregulloren e vetë në përputhshmëri të të plotë me dokumente normative që janë të parapara me Kornizë dhe njëkohësisht me Rezolutën 1244. Sa do të jetë komision në kuadër të ligjit apo ku ta dijë unë, mendoj që këtu duhet të jetë një komision i veçantë, shpejtë e shpejtë të miret kjo çështje dhe të zhvillojë zhvillimin normal i punimeve të këtij Kuvendi. Unë mendoj se do të ketë këtu probleme që duke mos pasur një rregullore të qartë, e cila do të definonte qartë edhe kompetencat edhe angazhimet edhe të deputetit, por edhe të Kryesisë së Parlamentit. Gjithashtu dua ta rispërsëris një nga mendimet që thanë deputetët më herët.Kisha dashur që në mbledhjen e ardhëshme,anëtarët e Kryesisë së Kuvendit t'i shofim në vendet e tyre ulur.Ju falemnderti.

**BUJAR DUGOLLI AAK**

Ne si grup parlamentar nuk jemi edhe aq të kënaqur si janë ndërtuar këto komisione duke marrë për bazë edhe me ndërtimin e këtyre komisioneve po krijohet një monopol. Në ato

parti që udhëheqin ministritë përkatëse, njejtën kohë udhëheqin edhe komisionet. Mendoj që është duhur të mendohet më mirë në këtë drejtim, të jetë parasysh një funksionim më i mirë dhe më efikas i këtyre komisione të Kuvendit. Unë mendoj që edhe kjo është pasojë, siç e tha z. Limaj, se ne punojmë me një rregullore të imponuar dhe jo të miratuar në Kuvend që mendoj nuk do të shkojë gjatë, por mendoj që të shqyrtohet edhe të zgjidhet kjo çështje. Megjithatë ne si grup parlamentar, pajtohemi që t'i ketë këto 16 komisione Kuvendi për fillim, duke pasur parasysh se informacionet që i kemi se në Kryesi nuk është arritur një pajtim që të ekzistojë Komisioni për të zhdukur dhe dëmet e luftës. Mendoj se ky komision është shumë i rëndësishëm, sidomos, për këtë fazë që po e kalojmë se ka shumë çështje që duhet të hulumtohen dhe duhet tu jipet një përgjegjje edhe popullit për këtë çështje. Mandej edhe komisioni anti-korrupsion siç i përkrahi edhe dy komisione tjera, siç u cekën për mendia dhe çështjet e imunitetit dhe mandateve. Mendoj se këto në rast se nuk kanë mundur të kalojnë në Kryesi dhe nuk mund të kalojnë as në mbledhjen tjetër, atëherë t'i votojmë këtu përveq 16 komisioneve
që janë dhe tash ma që kanë marrë një dritë jeshile të Kuvendit. Sa i përket delegimit ne i kemi deleguar, kryetarët dhe nënkryetarët e komisionit dhe mendoj se për anëtarët e komisionit, siç biseduam para mbledhjes me kryetarin e Kuvendit dhe me disa përfaqësues ndërkombëtar, duhet të lejohet një mundësi që grupi parlamentar i Aleancës do të thotë të jetë i përfaqësuar me gjitha komisionet, të paktën me një anëtar. Unë mendoj se kjo është në dobi të funksionimit të këtyre komisioneve, sepse deri më tash në 5 komisione ne nuk kemë asnjë anëtarë. Mendoj se këtë Kryesia do të ketë parasysh në mbledhjen e ardhshme dhe do të gjejë përgjigjëje për këtë. Ju falemnderit,

**NUMAN BALIĆ**

Ja bih se ponovo vratio na pitanje tehnike i organiziranja ovih sastanaka. Mislim da uprkos tome što smo imali na raspolaganju 14 dana, ovaj posao nismo obavili. Ja prihvatam moj dio ogovornosti za moju neinformisanost, možda se nisam potrudio da da budem bio bolje informisan, ali činjenica je da ja ne mogu danas glasati za 16 komisia i da ne znam uopšte koji su u t,im komisijama. Znam da je taj posao relativno dobro obavljen i postoji relativno dobra zastupljenost, političkih partija, predstavnika manjina i

uglavnom manjinskih zajednica ali je činjenica da ipak to nemamo na papiru i nemamo to pred svojim očima i što jednostavno znaći da ne treba izglasati u kratkom roku. Uz to ja bih predložio i jednu stvar: predloge koje postoje da razmotrimo i proučimo prije glasanja. Takođe imam jedan konkretan predlog, Ja mislim da s obzirom broj komisija kojih ima 16, i verovatno će doći do povećanja broja komisije a to već se vidi, ako smo povećali broj članova Predsedništva, dakle sada možemo povećati sva odgovarajuća tjela ovdje u Skupštini, i vjerovatno će to ići tim putem. Pre ili kasnije to će se verovatno utvrditi, dakle mislim na taj broj od 16 članova. Meni je žao što nisam mogao da budem direktno uključen, ali iz redova manjina Bošnjaka, Turaka, Haškalije, Egipćana, Roma, kao što sam već rekao, veliki problem je što ima 5 naroda a to treba odrediti 1 koji će se predstavljati sve njih, to je za nas strahovit problem. Mi do sada imamo predstavnika u ministarstvu, predstavnika u Predsedništvu Skupštine, ali zato nemamo nigde na bilokom značajnom mestu čoveka i redova Haškallije i Egipćana koji su bilo gde zastupljeni, Tako bih ja predložio da umesto jednog predsedavajućeg odbora ili komisiji kako hoćete, koji su predviđeni iz redova predstavnika ne srpske nealbanskih manjina budu dva predsedavajuća poslonika odbora.

Mislim da bi to trebalo razmotriti, i da ima prostora na kraj krajeva i u skladu sa brojem poslanika koji iz pomenuti redova 13 što je nešto više od 10%. Neko će sad politizirati. Nеču ulaziti u polemiku apsolutno i koji su ljudi dobri i koji nisu dobri, ali je činjenica, neosporna je činjenica da bi trebalo da budu bar dva predsedavajuća ovih odbora ili komisija iz redova ovih zajednica koje sam spomenuo. Takođe mislim da je potpuno na mestu predlog koji je Kelmendi iyneo da neke stranke koje su sasvim male ili imaju sasvim mali broj iz albanske zajednice, takođe trebaju biti zastupljene treba se omogućiti ako se borimo za pravdu da se povećava Predsedništvo, oprostite ja sam iskren i čvrsto na tome nikada od tog neću odustati, da damo više mesta i više prava u ono što smo malo prije spomenuli. Ako možemo povećati Predsedništvo te menjati ustavni okvir, oprostite možemo povećavati broj komisija i zadovoljiti sve ovde u ovom Parlamentu, Mislim da svako drugo rešenje nije pravilno i nije dobro. Hvala lepo.

Urdhëroni z. deputete

I nderuari z. Kryetar, të nderuar z. deputetë,

Unë në fakt jam deputete e Parlamentit të Kosovës dhe vij nga Gjakova, dhe vij me porosinë nga familjarët e pengjeve të luftës asesi të zhdukurve dhe ata që kanë shkuar i kanë marrë të gjallë dhe ne ende i presim të gjallë. Prandaj, kemi kërkesën që të themelohet një komision për zbardhjen e fatit të pengjeve të luftës dhe nëse ajo nuk është e mundur dhe ne kemi biseduar edhe në kuadër të grupit parlamentar dhe ne do të kërkojmë, personin i cili do të përfshihet drejtëpërdrejtë te përfaqësuesi special i OKB-së për Kosovën që të miret me këtë çështje. Jemi n ë formimin dhe miratimin e këtyre komisioneve ne gjithësesi duhet të vendosim dhe cila do të jetë mënyra dhe si të zbardhet fati i të gjitha pengjeve të luftës gjithmonë duke ikur nga emërtimi, sepse nga ne asnjeri nuk e ka asnjë argument për zhdukjen e tyre por kemi vetëm argumente se ata janë të gjallë. Ne jemi në dijeni se janë formuar shumë shoqata joqeveritare, por a vlen që vetëm në organizma joqeveritare të bëhet kjo. Ju falemnderit.

**NEXHAT DACI**

Para se t'ju jap fjalën vetëm një sqarim. Mund të debatojmë edhe sot edhe nesër, por vetëm një informatë, vetëm dy komitete janë të obliguara, vetëm dy këshilla dy komisione, nuk ka asnjë kufizim askund në Kornizë Kushtetuse sa do t'i fomojmë. Unë ju lus për t'i hapur një mundësi pune Parlamentit Sot ta mitatojnë vendimin e Kryesisës së Parlamentit dhe në asnjë mënyrë nuk përbyllet me këtë numër 16 një fjali vetëm përfaqësuesve të "Kthimit" është shumë e vërtetë që i kanë thënë ato në të gjitha nivelet edhe në Kryesi megjithatë, është arritur vendim i plotë, i mirëfillët në të gjitha nivelet, prandaj për këto 16 komitete komisione apo këshilla ne mund të vendosim me shumë kompetencë sot. Dhe pikën tjetër të rendit të ditës unë e kisha eliminuar plotësisht dhe LDK-ja bëri propozime. Nuk mund të ndryshohet kjo, duhet të shkojë prapë në Kryesi të Kuvendit, por i hapet mundësia që komitetet që të funksionojnë dhe të funksionalisohet krejtë jeta në Parlament. Pas kësaj që donë dikush të diskutoj. urdhëroni z. Lajçi.

**DRITON LAJÇI PDK**

I nderuar kryetar, të nderuar kolegë,

Pa dashur për ta larguar idenë ate çfarë propozoi kryetari i Kuvendit, dua të bëjë një propozim konkret këtu para jush. E kam fjalën t e shoqëria civile, mendoj se ajo është shumë e p ranishme n ë Kosovë. Ja në n umër i madhë i t yre v etëm r ini j anë 2 00. Ja në shuma ndërkombëtare. Janë të gjitha fushat e organizimit të shoqërisë edhe në rini në kulturë, në ambient, shëndetësi, dhe në arsim. Mendoj se nuk e di se a duhet kompetencat, autorizimet në këtë fushë të jepet një komisioni apo të formohet një komision i veçantë. Mendoj se në Kosovë, ky segment i organizimit të shoqërisë duhet të ligjsohet përmes komisionit apo t'i bashkangjitet autorizimeve. Falemnderit.

Urdhëroni z. Deputet

**SYLEJMAN ÇERKEZI PD**

I nderuar kryetar, kolegë të nderuar,

Po shoh se shpeshherë po gërshetohen çështjet parimore dhe ato teknike. Sigurisht, si rrjedhojë e kësaj, më duket se lodhim më tepër pikërisht për hirë të transparencës, prandaj të gjithë jemi të painformuar. Siç u theksua edhe më tepër. Më tepër informohemi nga egzetarët se sa formohemi nga organet përgjegjëse për këto punë. Unë në radhë të parë, meqenëse Korniza Kushtetuese ndryshohet,do të kërkoja edhe grupi si grup parlamentar të ndryshohet në numër përbërës për derisa si opozitë defakto jemi 4 parti p olitike t ë cilat p ërfaqësohen n ë P arlament m e n ga n jë d eputet d he n uk është e mundur teknikisht të formojmë një grup parlamentar, Kështu që në këtë bazë unë do të shtroja një pyetje; A jemi të përfshirë në ndonjë komisionet të gjitha këto parti politike të cilat janë jashtë grupimeve të përfaqësuara në Kuvend?, Në qoftëse jo, atëherë të hudhet në propozim mundësia e numrit nga 5 në 3 ose 4 vetash formojmë një grup

Parlamentar nga partitë, politike jemi në radhë të parë edhe opozitë defatkto dhe tjetra përfaqësojmë partitë politike që duhet të kemi respekt për to dhe për ju. Ju falemnderit,

**SANIJE ALIU LDK**

Z. Kryetari, përfaqësues deputet,

Unë kam një propozim konkret, për një komision i cili mendoj që duhet të merret me problemin e çështjet e gruas të fëmijëve dhe të pleqëve prandaj e di që sot është kërkesë me gojë por unë do t'ia bëjë këtë Kryesisë së Parlamentit edhe me shkrim. Besoj se do të hasi në mirëkuptim edhe tek deputetët e Parlamentit të Kosovës. Ju falemnderit

Urdhëroni z. Deputetë

Unë desha vetëm diçka. Shkurt të jap mendimin tim në përkrahje të propozimit të kryetarit. Unë nuk e kam të qartë nëse puna jonë në Parlament zhvillohet nëpërmes grupeve parlamentar dhe nuk di se deri sot a janë konsultuar grupet parlamentare. Këte e them nga fakti se secili këtu përfaqëson një subjekt politik, përfaqëson edhe grupe etnike e tjera, prandaj nuk mund të bëjmë gjithmonë komisione ose komitete në bazë të interesave të caktuara. Në Rregulloren e punës thuhet se grup politik formon që ka 6 e më tepër depuetë ata që kanë më pakë shkojnë e ju bashkangjiten grupeve tjera dhe edhe aty ka marrëveshje të ngjajshme, Sa i përket numrit të komisioneve në Kornizë shkruan egzakt se Parlamenti mund të formojë komisione sipas nevojës dhe arsyeshmërisë që të mund t'i realizojë përgjegjësitë e veta. Prandaj ju thëras që të votojmë për këto komisione dhe në punën tonë të mëtejshme të shkojmë dhe në komisione tjera nëse kemi nevojë për to. Ju falemnderit,

**NEXHAT DACI**

Prandaj ju ftoj që të votojmë për 16 komitete të cilët e kanë kaluar procedurën e nevojshme, do të thotë 10 komitete kanë nominklaturën e ministrive.

Komiteti për buxhete, komiteti për komunitete, komiteti për bashkëpunim ndërkombëtar, komiteti për gatishmëri emergjente, komiteti për peticione publike, komiteti për çështjet ligjore legjislative dhe kushtetuese. Partitë që ju takojnë grupet parlamentare që ju takojnë i kanë propozuar kryetarët dhe zëvendës - kryetarët e këtyre komiteteve. Ju lutem kush është për këtë vendim?, të votojmë. Ju falemnderit. Prandaj konkludojmë që 16 komitetet e propozuara nga Kryesia, janë aprovuar dhe të gjitha kërkesat që janë parashtruar sot në diskutime që nuk i konteston askush të futen në procedurë të regulltë nëpërmjet grupeve parlamentare dhe nëpërmjet respektimit të të gjitha regullave deri sa nuk i ndryshojnë të tjerët. Pikën e fundit me arsye kisha dashur sot ta shtyejmë, sepse ashtu është e drejtë, e grupeve parlamentare, për eventuale, për ndryshimin e anëtarëve, nëpër ato komisione t'i përbajnë rregullave dhe mendoj që mund të pajtohemi plotësisht.
Ju falemnderit.